LIGJ
Nr. 73/2026

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9616, DATË 27.9.2006, "PËR LIBRIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006, "Për librin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Të shpallë veprimtari me interes publik e kombëtar prodhimin, mbrojtjen e librit dhe të produkteve të përafërta me të në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe përhapjen e promovimin e tij edhe jashtë territorit të vendit.".

Neni 2

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 2

Objekti i këtij ligji është:

a) përcaktimi i rregullave në fushën e prodhimit, botimit, ruajtjes, mbrojtjes në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe përhapjes e promovimit të librit e të produkteve të përafërta me të jashtë territorit të vendit;

b) krijimi i kushteve për botimin e librave të autorëve shqiptarë në gjuhë të huaj dhe anasjelltas;

c) aksesi i personave me aftësi të kufizuara në fushën e librit e të leximit;

ç) zhvillimi i kulturës së leximit, promovimit të librit e të autorëve;

d) promovimi i librit në formë digjitale.".

Neni 3

Në nenin 3, "Përkufizime", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. "**Libër**" është një vepër shkencore, letrare apo e çdo lloji tjetër, që publikohet si një tërësi unitare, në një vëllim ose në vëllime të ndryshme, e shtypshkruar ose në çfarëdolloj forme tjetër të lexueshme. Përfshihen në këtë përkufizim, në zbatim të këtij ligji, librat elektronikë që publikohen në mediume të tjera dhe materialet e tjera plotësuese të shtypshkruara, pamore, audio vizuale apo zanore, të cilat janë publikuar së bashku me librin dhe që përbëjnë një njësi unitare.".

2. Në pikën 2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas fjalës "për fëmijë" hiqen fjalët "dëftuesit e hekurudhave ose të rrugëve detare, repertorët, që përmbajnë vetëm të dhëna numerike, repertorët alfabetikë";

b) Pas fjalëve "e një kënge" hiqen fjalët "fletoret e muzikës për detyra".

3. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen si më poshtë:

"3. "**Libër në formë elektronike**" është një botim libri, i përbërë nga tekst, imazhe ose të dyja, të lexueshme në pajisje elektronike.

4. "**Autor**" është çdo person fizik ose një grup personash fizikë, që krijon vepër letrare, artistike, shkencore, produkt intelektual origjinal, i materializuar, pavarësisht nga forma dhe mënyra e të shprehurit.".

4. Në pikën 5, fjalët "106, të ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005, "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të" zëvendësohen me fjalët "127, të ligjit nr. 35/2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", i ndryshuar.".

5. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

"8. "**Librashitës**" është personi fizik ose juridik, që ushtron tërësisht ose pjesërisht veprimtarinë e shitjes së librave në mjedise tregtare dhe tregje elektronike.".

6. Pas pikës 11 shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:

"12. "**Importues**" është personi fizik ose juridik, që mundëson hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të materialeve të botuara, të shtypshkruara ose të prodhuara jashtë territorit.".

Neni 4

Titulli i kreut III ndryshohet si më poshtë:

"Institucionet dhe organet e librit dhe leximit".

Neni 5

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 8

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

1. Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit (në vijim QKLL) krijohet dhe funksionon si person juridik publik, buxhetor, me statusin e institucionit qendror, në varësi të ministrisë përgjegjëse për librin.

2. Misioni i QKLL-së është ndjekja dhe zbatimi i projekteve në fushën e librit, duke synuar përhapjen e kulturës së leximit në të gjithë vendin, nxitjen e krijimtarisë, forcimin e rolit promovues dhe edukativ të bibliotekave, si dhe mbështetjen e projekteve për promovimin e letrave shqipe në tregun evropian dhe atë botëror.

3. QKLL-ja kryen detyrat si më poshtë:

a) harton programet dhe financon projektet në fushën e librit;

b) mbështet botimet e librave dhe të revistave në fushën e letërsisë e të shkencave shoqërore edhe në format të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara;

c) krijon kushtet nxitëse për krijuesit në fushën e letërsisë, duke siguruar mbështetje financiare dhe organizon konkurse për dhënien e çmimeve kombëtare letrare;

ç) nxit e promovon librin, autorët dhe përkthyesit shqiptarë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

d) realizon dhe promovon në forma të ndryshme:

i. bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e librit;

ii. përkthime të veprave të autorëve shqiptarë në gjuhë të huaja;

iii. prezantime të letërsisë shqipe në nivel ndërkombëtar;

dh) financon programe përkthimi me prioritet përkthimin dhe botimin në gjuhë të huaja të veprave të autorëve shqiptarë, me qëllim promovimin ndërkombëtar të letërsisë shqipe. Fondet publike të destinuara për përkthimin përdoren në tërësinë e tyre për përkthimin e veprave nga gjuha shqipe në gjuhë të huaja, pa sjellë kosto shtesë për buxhetin e shtetit;

e) krijon kushtet për zhvillimin e kulturës së leximit në të gjitha grup-moshat, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

ë) promovon zhvillimin e rrjetit libror në të gjithë territorin e vendit dhe krijon kushtet për një qasje të shtuar drejt politikave të librit për lexuesit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me Qendrën e Botimeve për Diasporën;

f) bashkëpunon me institucione ndërkombëtare që veprojnë në fushën e librit;

g) monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e programeve e të projekteve që mbështet;

gj) bashkëpunon me organet shtetërore për zbatimin e politikave publike dhe akteve të tjera rregulluese në fushën e librit, si dhe me organizata që kanë në fokus zhvillimin dhe përhapjen e kulturës së librit;

h) siguron fonde të jashtme dhe burime të tjera të financimit në fushën e librit sipas legjislacionit në fuqi;

i) nxjerr akte administrative dhe realizon detyra të tjera, me natyrë trajnuese e promovuese, në përputhje me qëllimin e QKLL-së;

j) i propozon ministrisë përgjegjëse për librin ndryshime në legjislacionin në fuqi në fushën e librit;

k) çdo detyrë tjetër të ngarkuar me ligj apo akt nënligjor.

4. Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit nuk ushtron kompetencë licencuese, autorizuese apo klasifikuese mbi subjektet që ushtrojnë veprimtari botuese. Statusi i një subjekti si shtëpi botuese, distributor ose librari përcaktohet nga regjistrimi dhe ushtrimi i veprimtarisë sipas legjislacionit tregtar dhe tatimor në fuqi.

5. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të QKLL-së përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 6

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

Këshilli Kombëtar i Librit dhe i Nxitjes së Leximit

1. Këshilli Kombëtar i Librit dhe i Nxitjes së Leximit (KKLNL) krijohet si organ këshillimor i ministrit përgjegjës për librin për çështjet objekt të këtij ligji.

2. KKLNL-ja jep rekomandime për hartimin e politikave e të programeve për promovimin e librit, nxitjen e leximit dhe veprimtarisë botuese në vend për ruajtjen dhe mbrojtjen e traditës së librave të vjetër bukinistike, për rritjen e eksportit dhe përhapjen e librit shqip përtej kufijve shtetërorë.

3. KKLNL-ja mbështet organizimin e veprimtarive në fushën e librit, të panaireve, ekspozitave, konkurseve dhe të veprimtarive të tjera kombëtare e ndërkombëtare, me pjesëmarrjen e autorëve, përkthyesve, botuesve dhe librashitësve shqiptarë e të huaj, si dhe sugjeron dhënien e çmimeve, veçanërisht për botimet e veprave me rëndësi kombëtare e në fushat që vlerësohen parësore për kulturën kombëtare.”.

Neni 7

Në nenin 10 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në paragrafin e parë, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Përfaqësuesi i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë.”

2. Në paragrafin e parë, pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Drejtorin e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit.”.

3. Paragrafi i dytë riformulohet dhe numërtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Dy anëtarë, personalitete të njohura të fushës, caktohen nga ministri përgjegjës për librin për një periudhë 4-vjeçare dhe dy përfaqësues nga grupet e interesit.”.

Neni 8

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11
Mënyra e funksionimit të KKLNL-së

1. Mënyra e funksionimit dhe organizmit të KKLNL-së përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për politikat e librit dhe leximit.
2. Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit mbështet nga ana administrative mbledhjet e KKLNL-së.”.

Neni 9

Në nenin 12 bëhen këto shtesa:
1. Pas fjalëve “kulturore e shkencore” shtohen fjalët “dhe veprave të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara”.
2. Pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:
“Procedurat, kushtet, kriteret dhe masa e bashkëfinancimit të titujve të veprave të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të ministrit përgjegjës për librin dhe ministrit përgjegjës për çështjet sociale.”.

Neni 10

Pas nenit 15 shtohet neni 15/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 15/1
Çmimet Kombëtare të Letërsisë

1. Shteti shqiptar akordon çdo vit Çmimet Kombëtare të Letërsisë.
2. Kategoritë e çmimeve sipas pikës 1 të këtij neni propozohen nga QKLL-ja dhe miratohen nga KKLNL-ja.
3. Çmimet jepen për vepra të botuara gjatë vitit kalendarik paraardhës.
4. Juria emërohet brenda muajit janar dhe e ushtron mandatin për një vit kalendarik.
5. Juria ka në dispozicion të gjithë vitin për shqyrtimin e veprave.
6. Shpallja e fituesve bëhet jo më vonë se 20 dhjetori ose, për arsye të justifikuara, jo më vonë se 20 janari i vitit pasardhës.
7. Procedurat dhe përbërja e jurisë përcaktohen nga QKLL-ja.
8. Fondi planifikohet çdo vit në buxhetin e ministrisë përgjegjëse.”.

Neni 11

Në nenin 17 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:
1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:
“2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore planifikojnë dhe përcaktojnë në buxhetet vjetore përkatëse një zë të veçantë për blerjen e librave për bibliotekat publike të njësive të vetëqeverisjes vendore.”.
2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:
“3. Fondi për librin, i miratuar në buxhetin e organit qendror apo vendor, është i patjetërsueshëm.”.

Neni 12

Në nenin 19 emërtimi “Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” zëvendësohet me emërtimin “Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit”.

Neni 13

Në nenin 21, pas shkronjës “k” shtohet shkronja “l” me këtë përmbajtje:

“l. identifikuesi unik universal i veprës dhe i kopjes së saj gjenerohet në formën e një barkodi për çdo ekzemplar libri.

Ky identifikues përbëhet nga tre komponentë:

i. identifikuesi standard i veprës ose botimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare (ISBN dhe/ose DOI, kur aplikohet);

ii. të dhënat kohore të publikimit ose stampimit;

iii. një komponent unik i gjeneruar në mënyrë algoritmike për identifikimin individual të kopjes.

Identifikuesi unik universal nuk zëvendëson identifikuesit standardë ndërkombëtarë të veprës, si ISBN apo DOI, por i plotëson ata duke mundësuar identifikimin dhe gjurmueshmërinë e çdo kopjeje individuale në qarkullim.

Gjenerimi dhe administrimi i barkodeve unike kryhet nga Agjencia e të Drejtës së Autorit, e cila autorizohet posaçërisht për këtë funksion.”.

Neni 14

Pas nenit 22 shtohet neni 22/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 22/1

Kontrata tip autor–botues

1. Marrëdhënia ndërmjet autorit dhe shtëpisë botuese bazohet në kontratë me shkrim.

2. Kontrata tip, e miratuar me akt nënligjor nga ministri përgjegjës, përcakton elementet minimale të detyrueshme.

3. Marrëdhënia kontraktuale realizohet në dy forma:

a) transferim i të drejtave ekonomike;

b) shpërblim proporcional për çdo kopje të shitur.

Kontrata duhet të përcaktojë afatin, territorin, formatet e botimit, tirazhin, raportimin e shitjeve dhe afatet e pagesës.

4. Çdo klauzolë që përjashton të drejtën e autorit për informim mbi shitjet është e pavlefshme.”.

Neni 15

Neni 32 shfuqizohet.

Neni 16

Në nenin 35, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Kontrolli për respektimin e këtij detyrimi ushtrohet sipas legjislacionit në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.”.

Neni 17

Në nenin 42 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Fjalët “njësive administrative vendore” zëvendësohen me fjalët “njësive të vetëqeverisjes vendore” dhe fjalët “në Bibliotekën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë” hiqen.

2. Pas paragrafit të parë shtohen dy paragrafë, i dytë dhe i tretë me këtë përmbajtje:

“Biblioteka Kombëtare mban detyrimisht 3 kopje nga 5 botimet e dorëzuara dhe i shpërndan kopjet e tjera në:

a) bibliotekën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për çdo botim për titujt që i përkasin fushës së ligjit, politikave dhe qeverisjes, shkencave sociale, shkencave politike, integrimit evropian dhe tituj me tematika që mbështesin veprimtarinë parlamentare, sipas marrëveshjes së miratuar mes palëve; dhe

b) në institucionet e tjera publike në bazë të marrëveshjes së nënshkruar mes palëve dhe të miratuar nga ministri përgjegjës për librin.

Kur nga dorëzimi i kopjeve të detyruara pranë Bibliotekës Kombëtare kanë kaluar 10 vjet, përcaktimi i kushteve, kritereve dhe procedurave për shpërndarjen e kopjeve mbi numrin e detyruar të kopjeve të BKSH-së bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 18

Në nenin 48 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Shkronjat “b” dhe “dh” shfuqizohen.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Masat administrative me gjobë jepen nga Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut.”.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i masave administrative me gjobë bëhet në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, i ndryshuar.”.

Neni 19

Në të gjithë përmbajtjen e ligjit, emërtimet “ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” dhe “Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” zëvendësohen përkatësisht me fjalët “ministri përgjegjës për politikat e librit dhe leximit ” dhe “ministria përgjegjëse për politikat e librit dhe leximit”.

Neni 20

Në nenin 49, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Ngarkohet ministri përgjegjës për librin që brenda:

a) 12 muajve të miratojë vendimin për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të QKLL-së, në zbatim të pikës 3, të nenit 5, të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

b) 12 muajve të nxjerrë urdhrin për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të KKLNL-së, në zbatim të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

c) 12 muajve të miratojë vendimin për procedurat, kushtet, kriteret dhe masat e bashkëfinancimit të titujve të veprave të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, në zbatim të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”.

Neni 21

Aktet nënligjore

Aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien ndesh me të, do të zbatohen derisa nuk janë miratuar aktet nënligjore të parashikuara në këtë ligj.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.7.2026.

Shpallur me dekretin nr. 456, datë 30.7.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj